



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Zyra për Komunikim me Publikun
Kancelarija za Javno Komuniciranje
Office of Public Communication

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesa Direkte - Akuakulturë për gjashtëmuajorin e parë 2019

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të mbështesë sektorin e mbarështimit të peshqve në hurdha përmes Pagesave Direkte.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët / aplikuesit që aplikojnë për Pagesa Direkte - Akuakulturë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të shesin së paku **2500 kg peshk** të freskët (peshku i gjallë, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temperaturë +5° C i paketuar në vakum) brenda gjashtë (6) muajve, në Republikën e Kosovës ose jashtë vendit (eksport);
- Llojet e pranueshme të peshkut për subvencionim janë: Trofta dhe Krapit;
- Të jetë i licencuar nga MBPZHR për zhvillimin e aktiviteteve në Akuakulturë;
- Të jenë të regjistruar në AUV.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Kopja e licencës së MBPZHR-së;
- Kopjen e certifikatës së biznesit;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Dëshmi-vërtetim për obligimet e kryera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës
- Dëshminë për sasinë dhe vendin e origjinës së ushqimit për peshk;

- Dëshminë nga Administrata Tatimore e Kosovës për sasinë e shitur të peshkut të freskët (peshku i gjallë, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temperaturë +5° C i paketuar në vakum);
- Dëshmi se është i regjistruar në AUV;
- Dëshmi mbi pagesën e tatimit në pronë.

Mënyra subvencionimit:

Subvencionimi do të bëhet për kg të peshkut të shitur në vlerë prej 0.20 €/kg;

Subvencionohen të gjithë fermat - pronarët e hurdhave të peshkut që shesin së paku **2500 kg/peshk** të freskët (peshku i gjallë, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temperaturë +5° C i paketuar në vakum) brenda gjashtë muajve, në Republikën e Kosovës ose jashtë vendit (eksport).

Periudha e aplikimit:

Afati i aplikimit fillon nga data 15.07.2019 dhe mbaron me datë 15.08.2019